LIGJ
Nr.10 046, datë 24.12.2008

PËR RATIFIKIMIN E "MARRËVESHJES SË HUASË DHE TË PROJEKTIT NDËRMJET REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË DHE BANKËS GJERMANE PËR RINDËRTIM DHE ZHVILLIM (KFW) PËR FINANCIMIN E PROJEKTIT "SISTEMI I KANALIZIMEVE TË UJËRAVE TË ZEZA, KORÇA IV""

Në mbështetje të neneve 78, 83 pika 1 dhe 121 të Kushtetutës, me propozimin e Këshillit të Ministrave,

KUVENDI
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

VENDOSI:

Neni 1

Ratifikohet "Marrëveshja e huasë dhe e projektit ndërmjet Republikës së Shqipërisë, përfaqësuar nga Ministria e Financave dhe Ndërmarrja e Ujësjellës-Kanalizimeve, Korçë (UKKO) dhe Bankës Gjermane për Rindërtim dhe Zhvillim (KfW) për financimin e projektit "Sistemi i kanalizimeve të ujërave të zeza, Korça IV"", me një hua prej 15 000 000 (pesëmbëdhjetë milionë) eurosh.

Neni 2

Ky ligj hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare.

Shpallur me dekretin nr.6003, datë 13.1.2009 të Presidentit të Republikës së Shqipërisë, Bamir Topi

MARRËVESHJE PROJEKTI DHE HUAJE
E DATËS 8 TETOR 2008 NDËRMJET BANKËS GJERMANE PËR RINDËRTIM DHE ZHVILLIM (KFW), FRANKFURT AM MAIN, DHE REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË, PËRFAQËSUAR NGA MINISTRIA E FINANCAVE, TIRANË ("HUAMARRËSI") DHE NDËRMARRJA UJËSJELLËS- KANALIZIMEVE KORÇË (UKKO), KORÇË ("AGJENCIA PËR ZBATIMIN E PROJEKTIT) PËR 15,000,000.00 EURO - HUA

Parathënie

Qeveria Gjermane nëpërmjet KfW mbështet përmirësimin e sistemeve të kanalizimeve të ujërave të zeza dhe ujit të pijshëm në Korçë me financimin e bashkëpunimit financiar që përfshin 19,57 ml. euro të fondit të grantit. Kjo hua dhe marrëveshja e Projektit shërben për të përfunduar këtë mbështetje.

Bazë për këtë marrëveshje është marrëveshja që pritet të përfundojë midis Qeverisë së Republikës Federale të Gjermanisë dhe Qeverisë së Republikës të Shqipërisë në lidhje me bashkëpunimin financiar (FC) ("Marrëveshje Qeveritare").

KfW do të financojë sërish huanë e dhënë në përputhje me kushtet e kësaj kontrate nga

fondet e saj, si edhe nga fondet buxhetore me interes të ulët të ofruara nga Republika Federale e Gjermanisë për projektet që përmbushin standardet e politikave të zhvillimit për projektet e pranueshme. Termat dhe kushtet e huasë i përmbushin kërkesat e Organizatës për Bashkëpunim dhe Zhvillim Ekonomik (OBZHE) për t'u njohur si Asistencë Zyrtare për Zhvillim (ODA).

1. Huaja

1.1 Shuma. KfW-ja do t'i japë Huamarrësit një hua që nuk e kalon shumën prej 15,000,000.00 euro.

1.2 Qëllimi. Huamarrësi do t'ia kalojë huanë Agjencisë së Zbatimit të Projektit në përputhje me kushtet e përcaktuara në nenin 2. Agjencia e Zbatimit të Projektit duhet ta përdorë huanë vetëm për financimin e përfundimit të impiantit për trajtimin e ujërave të zeza, zëvendësimin e rrjetit të kanalizimeve dhe ndërtimin e kolektorëve kryesorë dhe e një pike shkarkimi të ujit të shirave në qytetin e Korçës, si dhe për shërbimet përkatëse të konculencës (Projekti). Ministria e Punëve Publike, Transportit dhe Telekomunikacionit, Agjencia e Zbatimit të Projektit dhe KfW-ja do të përcaktojnë detajet e projektit, si edhe mallrat e shërbimet që do të financohen nga huaja nëpërmjet një marrëveshjeje të veçantë, për të cilën duhet të bihet dakord me Huamarrësin e përfaqësuar nga Ministria e Financave.

1.3 Taksat, pagesat publike, detyrimet doganore. Taksat dhe detyrimet e tjera publike që duhet të shlyhen nga Huamarrësi apo Agjencia e Zbatimit të Projektit, si edhe taksat doganore nuk do të financohen nga huaja.

2. Kalimi i Huasë tek Agjencia e Zbatimit të Projektit

2.1 Marrëveshje e veçantë huaje. Huamarrësi do t'ia kalojë huanë Agjencisë Zbatuese në bazë të një marrëveshjeje të veçantë huaje. Agjencia Zbatuese e Projektit do të shlyejë shumën totale të principalit dhe interesin e paguar KfW-së nga Huamarrësi të shpërndara në mënyrë të barabartë brenda një periudhe prej 30 vjetësh që përfshin një periudhë kohe shtesë shlyerjeje prej 10 vjetësh, pas hyrjes në fuqi të Marrëveshjes së huasë.

2.2 Përkthim i vërtetuar. Përpara disbursimit të parë nga huaja, Huamarrësi do t'i dërgojë KfW-së një përkthim të vërtetuar në anglisht të marrëveshjes së veçantë për hua të përcaktuar në nenin 2.1.

2.3 Agjencia e Zbatimit të Projektit nuk i nënshtrohet asnjë detyrimi. Kalimi i huasë nuk përbën asnjë detyrim të Agjencisë së Zbatimit të Projektit kundrejt KfW-së në lidhje me detyrime për pagesat që kjo Marrëveshje përcakton.

3. Disbursimi

3.1 Kërkesë për disbursim. Në momentin që të gjitha kushtet para disbursimit në bazë të nenit 3.4 janë plotësuar, KfW-ja do të bëjë disbursimin e huasë në përputhje me ecurinë e projektit dhe sipas kërkesës së Agjencisë së Zbatimit të Projektit.

3.2 Marrëveshja e veçantë. Nëpërmjet një marrëveshjeje të veçantë, Ministria e Punëve Publike, Transportit dhe Telekomunikacionit, Agjencia e Zbatimit të Projektit dhe KfW-ja do të përcaktojnë procedurën e disbursimit, në mënyrë të veçantë provat që duhet të sigurojë Agjencia e Zbatimit të Projektit, të cilat vërtetojnë se shumat e huasë së kërkuar janë përdorur për qëllimet e përcaktuara në këtë Marrëveshje.

3.3 Afati i fundit për të kërkuar disbursim. KfW-ja rezervon të drejtën të refuzojë kërkesat për kryerjen e disbursimeve pas datës 31 dhjetor 2012.

3.4 Kushtet përpara disbursimit. KfW-ja duhet t'i kryejë disbursimet në bazë të kësaj marrëveshjeje vetëm në qoftë se:

a) Huamarrësi ka siguruar prova të kënaqshme për KfW-në, të cilat vërtetojnë se ai i ka përmbushur, sipas ligjeve kushtetuese dhe ligjeve te tjera, te gjitha kërkesat në lidhje me marrjen përsipër të të gjitha detyrimeve të saj që rrjedhin nga kjo Marrëveshje, duke përfshirë provat sipas nenit 10.4 (Përjashtimi nga taksat).

b) Firmat e autorizuara që përmenden në nenin 13.1 (Përfaqësimi i Huamarrësit dhe i Agjencisë së Zbatimit të Projektit) i janë dërguar KfW-së;

c) Garancia nga Republika Federale e Gjermanisë që përmendet në nenin 8 është në fuqi dhe vepron pa ndonjë kufizim;

d) Huamarrësi e ka paguar tarifën e menaxhimit të përcaktuar në nenin 4.2;

e) Nuk ka ndodhur asnjë rast mospagimi në kohë.

f) Nuk është krijuar asnjë rrethanë e jashtëzakonshme që të pengojë apo të rrezikojë seriozisht zbatimin, funksionimin apo qëllimin e projektit, ose kryerjen e detyrimeve të pagesës të ndërmarrë nga Huamarrësi në bazë të kësaj Marrëveshjeje.

Përpara disbursimit nga huaja, KfW-ja ka të drejtën t'i kërkojë ato dokumente dhe të dhëna të tjera që ajo i gjykon të nevojshme.

3.5 Heqja dorë nga disbursimi. Duke iu referuar përmbushjes së detyrimeve të tij, në bazë të nenit 11, Huamarrësi mund të refuzojë disbursimin e çdo shume huaje ende të padisbursuar me pëlqimin e KfW-së kundrejt pagesës së një kompensimi në bazë të nenit 3.6.

3.6 Kompensimi. Nëse Huamarrësi e refuzon disbursimin e një shume huaje, ose në qoftë se një shumë huaje nuk është disbursuar aspak ose nuk është disbursuar brenda afatit të përcaktuar në nenin 3.3 për arsye të tjera për të cilat KfW-ja nuk mund të mbajë përgjegjësi, Huamarrësi do t'i paguajë menjëherë KfW-së, me kërkesën e tij, një shumë të tillë që konsiderohet e nevojshme për të kompensuar KfW-në për humbjet që ka pësuar, shpenzimet apo koston që ka paguar KfW-ja, si rezultat i refuzimit të disbursimit të shumës së huasë në fjalë.

4. Tarifat

4.1 Tarifa e angazhimit. Huamarrësi do të paguajë një tarifë angazhimi të pakthyeshme në masën 0.25% në vit për shuma të padisbursuara të huasë. Tarifa e angazhimit do të llogaritet për një periudhë që fillon tre muaj pas nënshkrimit të kësaj Marrëveshjeje dhe që përfundon në datën kur kryhet disbursimi i plotë i huasë. Ajo duhet të paguhet çdo gjatëmujor dhe për vonesa në kryerjen e pagesave në 30 qershor dhe 30 dhjetor të çdo viti (secila një "Datë pagese"), por jo më herët se data e pagesës pas ditës në të cilën kjo Marrëveshje hyn në fuqi dhe vepron sipas nenit 14.10.

4.2 Tarifa e manaxhimit. Huamarrësi do t'i paguajë KfW-së një tarifë menaxhimi të pakthyeshme që paguhet e plotë njëherësh, e barabartë me 0.5% të shumës principale të huasë të përcaktuar në nenin 1.1, me të kaluar një periudhë tremujore pas nënshkrimit të kësaj Marrëveshjeje nga KfW-ja, por jo më vonë, ose me të kaluar një periudhë njëmujore, pasi të hyjë në fuqi kjo Marrëveshje sipas nenit 14.10 (në varësi të datës që është më e vonë) por, sidoqoftë, përpara disbursimit të parë nga huaja.

5. Interesi

5.1 Interesi (normë fikse interesi e caktuar me angazhimin e huasë.) Huamarrësi do të paguajë interes për huanë në një normë të vendosur nga KfW-ja me të hyrë në fuqi kjo Marrëveshje huaje mbi bazën e kushteve të tregut të kapitaleve që dominojnë në atë kohë në Bashkimin Monetar Europian për huatë afatgjata, duke marrë parasysh koston që duhet të paguajë KfW-ja për fondet rifinancuese siç përmendet në parathënie. Kështu, norma e interesit e përcaktuar nga KfW-ja dhe komunikuar Huamarrësit do të zbatohet deri në fund të afatit të huasë.

5.2 Llogaritja e interesit dhe datat e pagesës së interesit. Interesi mbi një shumë të disbursuar të huasë do të llogaritet duke filluar nga data (duke e përjashtuar) në të cilën është debituar shuma respektive e huasë në llogarinë e huasë që mbahet nga KfW-ja për Huamarrësin deri në datën (duke e përfshirë) në të cilën kreditohen shlyerjet respektive në llogarinë bankare të KfW-së të përcaktuar në nenin 7.3. Interesi do të llogaritet në përputhje me nenin 7.1 (Llogaritja). Interesi do të paguhet me kamatëvonesë në datat e pagesës (siç përcaktohet në nenin 4.1).

6. Shlyerja e Huasë dhe Parapagimi

6.1 Grafiku i shlyerjes. Huamarrësi do ta kthejë huanë si vijon:

Kësti	Data		Shuma	
1	30 qershor	2013	394,000.00	EURO
2	30 dhjetor	2013	394,00.00	URO
3	30 qershor	2014	394,000.00	URO
4	30 dhjetor	2014	394,000.00	EURO
5	30 qershor	2015	394,000.00	EURO
6	30 dhjetor	2015	394,000.00	EURO
7	30 qershor	2016	394,000.00	EURO
8	30 dhjetor	2016	394,000.00	EURO
9	30 qershor	2017	394,000.00	EURO
10	30 dhjetor	2017	394,000.00	EURO
11	30 qershor	2018	395,000.00	EURO
12	30 dhjetor	2018	395,000.00	EURO
13	30 qershor	2019	395,000.00	EURO
14	30 dhjetor	2019	395,000.00	EURO
15	30 qershor	2020	395,000.00	EURO
16	30 dhjetor	2020	395,000.00	EURO
17	30 qershor	2021	395,000.00	EURO
18	30 dhjetor	2021	395,000.00	EURO
19	30 qershor	2022	395,000.00	EURO
20	30 dhjetor	2022	395,000.00	EURO
21	30 qershor	2023	395,000.00	EURO
22	30 dhjetor	2023	395,000.00	EURO
23	30 qershor	2024	395,000.00	EURO
24	30 dhjetor	2024	395,000.00	EURO
25	30 qershor	2025	395,000.00	EURO
26	30 dhjetor	2025	395,000.00	EURO
27	30 qershor	2026	395,000.00	EURO
28	30 dhjetor	2026	395,000.00	EURO
29	30 qershor	2027	395,000.00	EURO
30	30 dhjetor	2027	395,000.00	EURO
31	30 qershor	2028	395,000.00	EURO
32	30 dhjetor	2028	395,000.00	EURO
33	30 qershor	2029	395,000.00	EURO
34	30 dhjetor	2029	395,000.0	EURO
35	30 qershor	2030	395,000.00	EURO
36	30 dhjetor	2030	395,000.00	EURO
37	30 qershor	2031	395,000.00	EURO
38	30 dhjetor	2031	395,000.00	EURO

6.2 Shumat e padisbursuara të huasë. Shumat e huasë të padisbursuara do të balancohen përkundrejt kështit të fundit respektiv të shlyerjes që është për t'u paguar në bazë të grafikut të shlyerjes, përveçse kur KfW-ja, me zgjedhjen e saj, vendos për një mënyrë tjetër balancimi alternativ në raste të veçanta.

6.3 Disbursimet pas fillimit të shlyerjes. Në qoftë se shumat e huasë disbursohen pasi ka filluar shlyerja, grafiku i shlyerjes siç jepet në Nenin 6.1. nuk do të preket, në rast se kësti respektiv për t'u shlyer në bazë të grafikut të shlyerjes është më i vogël se shuma e huasë së

papaguar. Nëse kësti për t'u shlyer e tejkalon shumën e huasë së papaguar, KfW-ja do ta zbresë shumën e barabartë me diferencën nga kësti për t'u shlyer, do ta pjesëtojë me kështet e mbetura ende pa paguar dhe do t'ia shtojë këtë shumë çdo kësti të papaguar të shlyerjes. KfW-ja rezervon të drejtën për të shtyrë marrjen në konsideratë të disbursimeve që janë bërë brenda 45 ditëve para datës respektive të agesës për përcaktimin e shumës së huasë së papaguar deri datën e dytë të maturimit pas disbursimit.

6.4 Parapagimi. Për parapagimin aplikohen si më poshtë:

a) E drejta e parapagimit. Në çdo datë pagese, Huamarrësi mund ta shlyejë Huanë plotësisht ose pjesërisht përpara afatit të maturimit, por të paktën në shumën e një kësti të shlyerjes sipas Nenit 6.1. Nëse Huamarrësi e kryen një pagesë të tillë të parakohshme, ai duhet të paguajë një kompensim parapagimi në bazë të nenit 6.4 e).

b) Njoftimi. Pagesa e parakohshme e një shume huaje në bazë të nenit 6.4 a) i nënshtrohet njoftimit për parapagim të KfW-së nga Huamarrësi jo më vonë se data 15, datë pune për bankat, në Frankfurt am Main përpara datës së caktuar për parapagim. Një njoftim i tillë është i pakthyeshëm; ai duhet të specifikojë datën në të cilën do të bëhet parapagimi dhe shumën përkatëse dhe e detyron Huamarrësin t'i paguajë KfW-së shumën e dhënë në datën e caktuar.

c) Parapagimi i detyrueshëm. Huamarrësi duhet t'i rimbursojë menjëherë KfW-së, me kërkesën e saj, një shumë ose të gjitha shumat e huasë për të cilat Huamarrësi nuk është në gjendje të vërtetojë se janë përdorur për qëllimet për të cilat është rënë dakord.

d) Shumat e huasë për t'u paguar. Huamarrësi do të paguajë gjithashtu shumat e mëposhtme së bashku me parapagimin:

aa) kompensimet për parapagimin në bazë të nenit 6.4 e) që janë për t'u paguar si pasojë e parapagimit; dhe

bb) të gjithë interesin e mbledhur mbi shumën e huasë së parapaguar deri datën e parapagimit.

e) Kompensimi për parapagimin. Nëse Huamarrësi e shlyen një shumë huaje përpara afatit të maturimit, Huamarrësi duhet t'i paguajë menjëherë KfW-së, me kërkesën e këtij të fundit, një shumë në masën që është e nevojshme për të kompensuar ndonjë humbje, shpenzim apo kosto që ka pasur KfW-ja, si pasojë e parapagimit. KfW-ja do të përcaktojë shumën e kompensimit për parapagimin dhe do t'ia komunikojë atë Huamarrësit.

f) Balancimi. Neni 6.2 (Shumat e padisbursuara të huasë) do të aplikojë *mutatis mutandis* për balancimin e pagesave të parakohshme.

6.5 Grafiku i rishikuar për shlyerjen e huasë. Në rast se neni 6.3 (Disbursimet pas fillimit së shlyerjes të huasë) apo neni 6.4 (Parapagimi) gjen zbatim, KfW-ja do t'i dërgojë Huamarrësit një grafik të rishikuar të shlyerjes së huasë, i cili do të bëhet pjesë përbërëse e kësaj Marrëveshjeje dhe do të zëvendësojë grafikët e shlyerjes të vlefshme deri në atë kohë.

7. Llogaritjet dhe pagesat në përgjithësi

7.1 Llogaritja. Interesi, tarifa e angazhimit, interesi për vonesat në pagesa sipas nenit 7.5, kompensimi i shumës së plotë për shumat që u ka kaluar afati i pagesës sipas nenit 7.6 dhe kompensimi për parapagimin sipas nenit 6.4 e) do të llogariten në bazë të një viti me 360 ditë dhe muaji me 30 ditë.

7.2 Data e caktuar për pagesë. Nëse një pagesë që duhet kryer në lidhje me këtë Marrëveshje qëllon që duhet të kryhet në një datë që nuk është ditë pune për Bankat, Huamarrësi duhet ta bëjë një pagesë të tillë ditën tjetër të punës. Nëqoftëse dita tjetër e punës qëllon në muajin tjetër kalendarik, kjo pagesë duhet të bëhet në ditën e punës që është para kësaj date.

7.3 Numri i llogarisë bankare, koha e kreditimit. Huamarrësi do të çlirohet nga detyrimet e tij të pagesës në lidhje me këtë Marrëveshje, në qoftë se dhe sapo shumat respektive t'i jenë kredituar KfW-së pa zbritje në euro dhe jo më vonë se 10:00 paradite në llogarinë e KfW-së me numër 3100099730, në Frankfurt am Main (bank sort code 500 204 00, BIC KFWIDEFF, me referim shtesë "Ref. YYYYMMDD") ose në një llogari tjetër për të cilën njofton KfW-ja.

7.4 Kundërkërkesat e Huamarrësit. Huamarrësi nuk e ka të drejtën të ushtrojë të drejta të

mbajtjes së tatimit në burim apo kundërbalancimit apo të drejta të krahasueshme kundrejt detyrimeve të pagesës në bazë të kësaj Marrëveshjeje, përveç kur të drejta të tilla i njihen nga një vendim deklarativ i gjykatës (rechtskräftig festgestellt) apo kur nuk janë kundërshtuar nga KfW-ja.

7.5 Interesi për vonesa në pagesa. Nëse kështet e shlyerjes apo parapagimet sipas nenit 6.4 (Parapagimi) nuk i paguhen KfW-së në kohë, KfW-ja, pa njoftim paraprak, ka të drejtën të mbajë interes për vonesat në pagesë sipas normës bazë të interesit të bankës duke i shtuar 3% në vit për periudhën që fillon në datën e përcaktuar të pagesës dhe që mbaron në datën kur kjo pagesë derdhet në llogarinë e KfW-së të përcaktuar në nenin 7.3 të kësaj Marrëveshjeje. Kjo normë duhet që të paktën të jetë e barabartë me normën e interesit sipas nenit 5.1 (Interesi). "Norma bazë" është norma e interesit e shpallur si e tillë nga Banka Qendrore Gjermane (Deutche Bundesbank) që zbatohet në datën përkatëse të caktuar për pagesën. Një interes i tillë i mbajtur për vonesat në pagesë duhet të paguhet menjëherë që me kërkesën e parë të KfW-së.

7.6 Kompensimi i shumës totale. Për shumat që u ka kaluar afati i pagesës (me përjashtim të kësteve të shlyerjes dhe parapagimeve që përmenden në nenin 7.5 [Interesi për vonesat në pagesë] KfW-ja, pa njoftim paraprak, mund të kërkojë kompensim të shumës totale prej 3% në vit mbi normën bazë që aplikohet në datën respektive të caktuar për pagesën për periudhën që fillon në datën e përcaktuar të pagesës dhe që mbaron në datën kur bëhet pagesa e këtyre shumave që u ka kaluar afati i pagesës. Kompensimi i shumës totale duhet të bëhet me të bërë kërkesën e parë KfW-ja.

7.7 Balancimi. KfW-ja ka të drejtë të balancojë pagesat e marra kundrejt pagesave që janë për t'u kryer sipas kësaj Marrëveshjeje ose marrëveshjeve të tjera huaje të lidhura ndërmjet KfW-së dhe Huamarrësit.

8. Garancia nga Republika Federale e Gjermanisë

KfW-ja do të ketë pretendime për pagesat sipas kësaj Marrëveshjeje të garantuara nga Republika Federale e Gjermanisë përpara kryerjes së disbursimit të parë.

9. Garancia negative dhe pari passu

9.1 Asetet e projektit. As Huamarrësi e as Agjencia Zbatuese e Projektit nuk mund të lërë peng, hipotekojë, krijojë detyrime të tjera apo të shesë asetet e projektit përpara shlyerjes së plotë të Huasë pa marrë pëlqimin paraprak të KfW-së.

9.2 Pari Passu. Në shkallën që e lejon ligji, Huamarrësi merr përsipër të përmbushë detyrimet e përcaktuara nga kjo Marrëveshjeje pari passu me të gjitha detyrimet e saj ekzistuese apo të ardhshme të pasiguruara dhe jo të varura të pagesës.

10. Kostoja dhe detyrimet publike

10.1 Nuk do të ketë zbritje apo mbajtje tatimi në pagesa. Huamarrësi do t'i kryejë të gjitha pagesat e përcaktuara nga kjo Marrëveshje pa zbritur nga këto të fundit taksat, detyrime të tjera publike, apo kosto të tjera. Në rast se Huamarrësi është i detyruar nga ligji apo nga arsye të tjera që t'i bëjë këto zbritje apo mbajtje tatimi në pagesa, pagesat e bëra nga Huamarrësi do të rriten në atë masë që konsiderohet e nevojshme në mënyrë që KfW-ja t'i marrë të plota shumat që janë për t'u paguar sipas kësaj Marrëveshjeje pas zbritjes së taksave dhe detyrimeve publike.

10.2 Kostoja. Huamarrësi do të mbulojë të gjithë koston dhe shpenzimet e bëra në lidhje me disbursimin e Hhasë, në veçanti koston e transferimit dhe dërgesës së parave (përfshirë tarifat e konvertimit), si edhe të gjithë koston dhe shpenzimet e bëra në lidhje me mbështetjen apo zbatimin e kësaj Marrëveshjeje.

10.3 Taksa dhe detyrime të tjera. Huamarrësi do të mbulojë koston e të gjitha taksave dhe detyrimeve të tjera publike, të bëra jashtë territorit të Republikës Federale të Gjermanisë, në lidhje me përfundimin dhe zbatimin e kësaj Marrëveshjeje.

10.4 Përjashtimi nga taksat. Përpara disbursimit të parë nga Huaja, Huamarrësi do të sigurojë që KfW-ja të përjashtohet nga çdo lloj dhe të gjitha taksat mbi të ardhurat nga interesi, komisionet dhe detyrime të ngjashme në Shqipëri kur të japë huanë.

11. Projekti

11.1 Zbatimi i projektit dhe të dhëna të veçanta. Agjencia e Zbatimit të Projektit

a) Do të përgatisë, zbatojë, vërë në veprim dhe mbështesë financiarisht projektin duke iu përmbajtur praktikave të shëndosha financiare dhe teknike në lidhje me projektin, si dhe në përputhje në thelb me konceptimin e projektit, për të cilin është rënë dakord ndërmjet Agjencisë Zbatuese dhe KfW-së;

b) Do të zgjedhë konsulentë inxhinierë të pavarur dhe të kualifikuar për përgatitjen dhe mbikëqyrjen e ndërtimit të projektit dhe firma të kualifikuara për zbatimin e projektit;

c) Do të lidhë kontratat për mallrat dhe shërbimet, të cilat do të financohen nga huaja pas kryerjes së procedurave të një tenderi ndërkombëtar;

d) Do të mbajë libër llogarish e procesverbale të cilat tregojnë në mënyrë të qartë të gjitha kostot e mallrave dhe shërbimeve që nevojiten për Projektin dhe që identifikojnë në mënyrë të qartë tipin e mallit dhe të shërbimit të financuar nga kjo hua, ose do të caktojë një palë të tretë ta bëjë këtë;

e) Do të bëjë të mundur që përfaqësues të KfW-së, në çdo kohë, të kenë mundësi t'i kontrollojnë këto të dhëna, si dhe çdo dokument tjetër që ka të bëjë me zbatimin dhe funksionimin e projektit, si dhe të vizitojnë zonën e projektit, si dhe të gjitha ndërtimet përkatëse;

f) Do t'i sigurojnë KfW-së çdo informacion dhe të dhënë mbi projektin dhe mbi ecurinë e tij sipas kërkesës së KfW-së;

g) Me iniciativën e vet dhe pa asnjë vonesë:

aa) Do t'i dërgojë KfW-së pyetjet që i kanë ardhur Huamarrësit nga OECD-ja apo anëtarët e saj në bazë të së ashtuquajturës "Marrëveshje për Transparencë të Kreditimeve të Palidhura të ODA-s" pas lidhjes së kontratave për mallrat dhe shërbimet që do të financohen nga huaja dhe do të koordinojë me KfW-në përgjigjen për pyetje të tilla dhe

bb) Do të informojnë menjëherë KfW-në për çdo rrethanë që bën të pamundur ose rrezikon në mënyrë serioze zbatimin, funksionimin ose qëllimin e projektit.

11.2 Marrëveshja e veçantë. Ministria e Punëve Publike, Transportit dhe Telekomunikacionit, Agjencia e Zbatimit të Projektit dhe KfW-ja do të përcaktojnë detajet e nenit 11.1 me anë të një marrëveshjeje të veçantë.

11.3 Sigurimi i financimit të plotë. Huamarrësi dhe Agjencia e Zbatimit të Projektit do të sigurojnë financimin e plotë të projektit dhe, nëse i kërkohet, do t'i sigurojë KfW-së prova që vërtetojnë se kostot që nuk mbulohen nga huaja janë paguar.

11.4 Informacioni. Huamarrësi dhe Agjencia e Zbatimit të Projektit, me iniciativën e tyre, do të njoftojnë menjëherë KfW-në: i) kur ndodh ose mund të ndodhë një rast i mospagimit në kohë; ii) për çdo rrethanë që bën të pamundur ose rrezikon në mënyrë serioze zbatimin, ose qëllimin e kësaj Marrëveshjeje.

11.5 Asistencë. Huamarrësi dhe Ministria e Punëve Publike, Transportit dhe Telekomunikacionit do ta ndihmojë Agjencinë Zbatuese në përputhje me praktika të qëndrueshme financiare dhe teknike gjatë zbatimit të kësaj Marrëveshjeje, si dhe në shlyerjen e detyrimeve të Agjencisë Zbatuese që përcaktohen në këtë Marrëveshje dhe, veçanërisht, t'i ofrojë Agjencisë Zbatuese të gjitha lejet e nevojshme për zbatimin e kësaj Marrëveshjeje.

11.6 Pajtueshmëria. Huamarrësi, Ministria e Punëve Publike, Transportit dhe Telekomunikacionit dhe Agjencia Zbatuese do të sigurojnë që personat e ngarkuar me përgatitjen dhe zbatimin e projektit, lidhjen e kontratës për mallrat dhe shërbimet që do të financohen, dhe me kërkesën për disbursimin e shumave të huasë, të mos kërkojnë, pranojnë, bëjnë, japin, premtojnë ose marrin premtimin për pagesa të paligjshme apo përfitime të tjera në lidhje me këto detyra.

11.7 Transporti i mallrave. Transporti i mallrave, që do të financohet nga huaja do t'u nënshtrohet dispozitave të përcaktuara në marrëveshjen qeveritare, të cilat njihen nga Huamarrësi dhe Agjencia Zbatuese.

12. Rastet e mospagimit në kohë.

12.1 Rastet e Mospagimit në kohë. KfW-ja mund të anulojë huanë plotësisht ose pjesërisht nëse:

a) Huamarrësi nuk arrin të përmbushë detyrimet e tij ndaj KfW-së, për kryerjen e pagesave në kohë;

b) Janë shkelur detyrimet e përcaktuara nga kjo Marrëveshje ose nga marrëveshjet e veçanta që janë pjesë e kësaj Marrëveshjeje;

c) Huamarrësi dhe/ose Agjencia Zbatuese nuk është në gjendje të vërtetojë se shumat e huasë janë përdorur për qëllimet e përcaktuara në këtë marrëveshje, ose

d) Kjo Marrëveshje apo ndonjë pjesë e saj nuk ka më efekt detyrues mbi Huamarrësin ose nuk është më e detyrueshme për t'u zbatuar nga ana e Huamarrësit;

e) Krijohen rrethana të veçanta që bëjnë të pamundur ose rrezikojnë në mënyrë serioze zbatimin, fuksionimin ose qëllimin e kësaj huaje, ose kryerjen e pagesës së detyrimeve financiare të marra përsipër nga Huamarrësi e të përcaktuara në këtë Marrëveshje.

12.2 Pasojat ligjore në rastin e mospagimit në kohë. Nëse rastet e përcaktuara në nenin 13.1 janë krijuar dhe nuk janë zgjidhur brenda një periudhe të përcaktuar nga KfW-ja, e cila duhet të jetë të paktën prej 30 ditësh, KfW mund t'i japë fund kësaj Marrëveshjeje ose çdo pjese të saj me pasojë që

a) Të anulohen detyrimet e saj të përcaktuara në këtë Marrëveshje, dhe që:

b) KfW-ja të mund të kërkojë shlyerjen e plotë apo të pjesshme të shumave të huasë së papaguar, si dhe pagimin e të gjithë interesave të mbledhur, si dhe shuma të tjera që janë për t'u paguar në bazë të kësaj Marrëveshje, me nenin 7.5 (Interesi për vonesat në pagesa) dhe 7.6 (Kompensimi i shumës totale) që aplikohet në shumat e përshpejtuara *mutatis mutandis*.

12.3 Kompensimi për dëmet. Në rast se kësaj Marrëveshjeje i jepet fund plotësisht ose pjesërisht, Huamarrësi do të paguajë kompensimin në përputhje me nenin 3.6 dhe/ose kompensimin e parapagimit në përputhje me nenin 6.4 e).

13. Përfaqësia dhe deklaratat

13.1 Përfaqësimi i Huamarrësit dhe i Agjencisë së Zbatimit të Projektit. Ministri i Financave dhe individë të caktuar nga ai/ajo për ta përfaqësuar te KfW-ja dhe të autorizuar për të nënshkruar me anë të firmave të vërtetuara prej tij/saj do të përfaqësojnë Huamarrësin gjatë zbatimit të kësaj Marrëveshjeje. Drejtori i Agjencisë Zbatuese dhe individë të tillë të caktuar nga ai/ajo për ta përfaqësuar te KfW-ja dhe të autorizuar për të nënshkruar me anë të firmave të vërtetuara prej tij/asaj do të përfaqësojnë Agjencinë Zbatuese gjatë zbatimit të kësaj Marrëveshjeje. Prokurat e përfaqësimit do të jenë të vlefshme derisa KfW-ja të marrë njoftimin për anulimin e tyre nga përfaqësuesit e autorizuar të Huamarrësit dhe/ose Agjencisë Zbatuese.

13.2 Adresat. Çdo njoftim apo deklaratë në lidhje me këtë Marrëveshje duhet të bëhen me shkrim. Ato duhet të dërgohen në origjinal ose – me përjashtim të kërkesave për disbursim – me faks. Çdo njoftim apo deklaratë e bërë në lidhje me këtë Marrëveshje duhet të dërgohet në adresat e mëposhtme:

Për KfW-në: Kreditanstalt fur Wiederaufbau
Postfach 11 11 41
60046 Frankfurt am Main
Germany
Fax: +49 69 7431- 2944

Për Huamarrësin: Ministria e Financave
Bul. "Dëshmorët e Kombit," nr.4
Tirana
Republika e Shqipërisë
Fax: +355- 42-228494

Për Agjencinë Zbatuese:
Ujësjellës-Kanalizime Korça (UKKO)

Water Supply and Sewerage Enterprise

Rr. "Unaza e Qytetit" Rajoni nr. 2
Korçë, Albania
Fax: +355-82- 457 59

14. Dispozita të përgjithshme

14.1 Ditë pune. Kur në këtë Marrëveshje përdoret termi "Ditë pune", ai nënkupton çdo ditë, me përjashtim të së shtunës dhe të dielës, në të cilën bankat tregtare në Frankfurt am Main janë të hapura për veprime bankare të përgjithshme.

14.2 Vendi i shlyerjes së detyrimeve. Vendi i shlyerjes së të gjitha detyrimeve të përcaktuara në këtë Marrëveshje është Frankfurt am Main.

14.3 Pavlefshmëria e pjesshme dhe boshllëqet. Nëse ndonjëra nga dispozitat e kësaj Marrëveshjeje është apo bëhet e pavlefshme, ose në rast se ka ndonjë boshllëk në ndonjë prej dispozitave të kësaj Marrëveshjeje, kjo nuk do të ndikojë në vlefshmërinë e dispozitave të tjera të kësaj Marrëveshjeje. Palët pjesëmarrëse në këtë Marrëveshje do të bëjnë zëvendësimin e dispozitave të pavlefshme me dispozitat ligjërisht të vlefshme që i përafrohen më shumë frymës dhe qëllimit të dispozitës së pavlefshme dhe do të mbushin boshllëqet e krijuara ne dispozita me dispozita ligjërisht të vlefshme në përputhje me frymën dhe qëllimin e kësaj Marrëveshjeje.

14.4 Forma e shkruar. Amendamentet ose shtesat në këtë Marrëveshje duhet të bëhen me shkrim në mënyrë që të jenë të vlefshme. Çdo heqje dorë nga kjo kërkesë për formë të shkruar duhet të njoftohet me shkrim nga palët kontraktuese.

14.5 Transferimi. Huamarrësi nuk mund të caktojë, të transferojë, të lerë peng ose të hipotekojë të drejta nga kjo Marrëveshje.

14.6 Ligji i zbatueshëm. Kjo Marrëveshje do të rregullohet nga ligjet e shtetit gjerman.

14.7 Periudha e kufizimit. Të gjitha të drejtat që gëzon KfW-ja në bazë të kësaj Marrëveshjeje skadojnë pas pesë vjetësh duke filluar nga fundi i vitit në të cilin ka lindur kjo e drejtë dhe në të cilin KfW-ja është bërë e vetëdijshme për rrethanat që përbëjnë këtë të drejtë ose në të cilin mund të ishte bërë e vetëdijshme në lidhje me to pa neglizhencë të plotë.

14.8 Arbitrazhi. Të gjitha konfliktet që lindin nga kjo Marrëveshje dhe në lidhje me të do të zgjidhen përfundimisht dhe vetëm nga një gjykatë arbitrazhi. Në lidhje me këtë, do të zbatohen si më poshtë:

a) Gjykata e arbitrazhit do të përbëhet nga një ose tre gjyqtarë të cilët do të emërohen dhe do të veprojnë në përputhje me rregullat e arbitrazhit të Dhomës Ndërkombëtare të Tregtisë (ICC) që gjejnë zbatim herë pas here.

b) Seancat e arbitrazhit do të zhvillohen në Frankfurt am Main. Seancat do të zhvillohen në gjuhën angleze.

14.9 Transmetimi i informacionit. KfW-ja rezervon të drejtën t'i japë Republikës Federale Gjermane informacion lidhur me përfundimin dhe zbatimin e kësaj Marrëveshjeje. KfW-ja dhe Republika Federale e Gjermanisë kanë të drejtën t'u japin informacione në lidhje me huanë dhe projektin, duke përfshirë lidhjen e kontratave për mallrat dhe shërbimet që do të financohen nga huaja, organizatave ndërkombëtare të angazhuara për mbledhjen e të dhënave statistikore sidomos në lidhje me aspekte të shlyerjes së interesit dhe principalit, dhe/ose mbledhjen dhe publikimin e të dhënave për lidhjen e kontratave për mallrat dhe shërbimet që do të financohen nga huaja. E drejta e lartpërmendur për t'u dhënë informacion organizatave ndërkombëtare përfshin gjithashtu edhe të drejtën për t'u dhënë drejtpërsëdrejti një informacion të tillë anëtarëve të këtyre organizatave.

14.10 Hyrja në fuqi. Kjo Marrëveshje do të hyjë fuqi pasi të ketë hyrë në fuqi dhe të veprojë Marrëveshja Qeveritare mbi të cilën ajo bazohet.

Kjo Marrëveshje realizohet në 3 kopje origjinale në gjuhën angleze____ ,këtë ditë të, _____2008,

KfW-ja Ministria e Financës

UKKO